

TIMONIN E SË ARDHMES E KEMI NE



JETA E NJË QYTETARI NË DEMOKRACI

DIAR (12), ERMIR (11), QENDRESA (11), LORIK (11), ELSA (11), FATBARDHA (11)


Ne jemi disa nga nxënësit e klasës së VI-të nga shkolla „Akrashticë“ dhe në grupin tonë diskutuam për demokracinë. Nëse dëshironi të dini më shumë rreth diskutimit tonë lexojeni këtë artikull

Kujdestarja jonë quhet Haxhere Kuqi Mehmeti. Ajo na edukon dhe na mëson neve, ka të drejtën e punës dhe po ashtu ka të drejtën e jetesës si të gjithë ne. Ajo bashkëpunon me kolegët e saj dhe me të gjithë nxënësit. A thua vallë, pse ajo i ka këto të drejta dhe këtë liri? Të gjitha këto i ka, sepse jeton në një vend demokratik. Fjala demokraci rrjedh nga greqishtja që „demos“ do të thotë popull dhe „kratia“ udhëheqje. Janë dy forma të demokracisë: demokracia e drejtpërdrejtë dhe demokracia përfaqësuese. Në demokracinë e drejtpërdrejtë populli vendos aty për aty, ndërsa në demokracinë përfaqësuese populli i voton dhe zgjedhë përfaqësuesit e vet.


Grupi ynë mendon se demokracia është forma më e mirë e qeverisjes dhe të gjitha këto të drejta që ne i kemi duhet t'i shfrytëzojmë në mënyrën më të mirë të mundshme.




Grupi që e shkruajtën këtë artikull



E drejta e shprehjes së mendimit



E drejta e votës




Disa nga elementet e demokracisë



E drejta e shkollimit

RËNDËSIA E MEDIAVE NË DEMOKRACI

MIMOZA (12), ALMEDINA (12), EDMOND (11), SMAJL (12), GRESA (12), GETUAR (11), ERJONA (12)



Paramendojeni jetën tuaj pa televizor, pa radio apo pa telefon. Sigurisht se është shumë e vështirë, sepse ato tashmë janë pjesë e jona

„Demokrati quhet demokracia mediale“, është kjo një thënie e Warren Christopher, i cili ishte Sekretar i Shteteve të Bashkuara të Amerikës. Vendosëm ta nisim artikullin tonë me këtë thënie, sepse pajtohemi plotësisht me të, por edhe sepse lidhet me temën tonë. Në fillim, në grupin tonë diskutuam rreth demokracisë. Pastaj, folëm, më gjerësisht në lidhje me rolin që kanë mediat në demokraci.


Gjatë diskutimit, kuptuam se mediat me të drejtë konsiderohen si „Pushteti i Katërt“. Pse? Sepse mediat luajnë rolin e një „gjyqtari“ që gjykon institucionet shtetërore. Ky „gjykim“ i mediave gjithmonë ndodh duke i mbrojtur interesat e popullit dhe duke mbajtur anën e të së vërtetës.

Në demokraci, ne si popull e kemi fjalën kryesore, sepse me anë të votës tonë zgjedhen përfaqësuesit e vendit.

Megjithatë, për ta bërë këtë, populli ka nevojë të informohet mirë. Kur e themi këtë, nënkuptojmë informim të drejtë, të saktë dhe të paanshëm.

Marrim shembull, kur të arrijmë moshën 18 vjeçare ne do të kemi të drejtë të votojmë për përfaqësuesit tonë. Por, si do ta bënim këtë nëse nuk do të dinim se çfarë planprogrami kanë kandidatët e caktuar? Për këtë arsye shërbejnë mediat. Ato na informojnë për çdo gjë që ndodh mes nesh, por edhe në tërë botën. Si do ta dinim ne që një tërmet ka ndodhur në Itali? Sigurisht se dikur do ta kuptonim, por informimi do të ishte shumë më i ngadalshëm.

Sot, në një kohë kaq dinamike, mediat kanë rëndësi më të madhe se kurrë.



Mediat në demokraci



Autorët e artikullit duke punuar

Vazhdoni të lexoni dhe të kuptoni më shumë për mediat dhe rëndësinë e tyre. Kjo është pjesa e dytë e artikullit tonë dhe shpresojmë se është duke iu pëlqyer

Mediat janë shumë të rëndësishme, sidomos kur është fjala për demokraci. Çfarë është një demokraci pa transparencën e saj? Kjo është demokraci jo e plotë dhe ai popull nuk do të ishte plotësisht popull demokratik, sepse do të jetonte në errësirë mediale. Të gjitha seancat plenare që mbahen në Kuvend, ne i përcjellim përmes televizioneve tona. Në të kundërtën, nuk do të kishim mundësi të ishim të informuar për të gjitha vendimet e Kuvendit.


„Medium“ është fjalë nga gjuha latine, që në gjuhën shqipe do të thotë komunikim. Edhe sot, ne e përdorim këtë shprehje, si dhe shprehjen „media“ në jetën e përditshme. Në vendin tonë ekziston Komisioni i Pavarur i Mediave. Ky komision përbëhet nga Këshilli, Zyra e Shefit Ekzekutiv, si dhe Bordi i Ankesave. Nëse një televizion dëshiron të ketë transmetim publik, duhet të kërkoj licencën nga ky Komision. Ne sot e kemi kuptuar rëndësinë dhe rolin e mediave në jetën tonë. Po shpresojmë që informatat që ua kemi treguar, kanë shërbyer që edhe ju të kuptoni rëndësinë dhe vlerën e mediave në demokraci.



Mediat në demokraci, padyshim që janë të pavarura



Luajnë rol shumë të rëndësishëm në jetën tonë



Mediat na tregojnë rreth planprogrameve të kandidatëve për deputetë



Shoqët tona këtu kanë paraqitur disa informata rreth mediave

PUSHTETI LEGJISLATIV

ELISA (11), EROLIND (11), GENTA (12), ERIJONA (12), RIAD (11), ELJONA (12), VEDAT (12)



Këtë vizatim e ka bërë shoku Erolind. Arsyeja pse e shkruajti kështu „Kuendi“, ishte sepse dëshironte të na tregonte se kur flasim për Kuvendin i cili është institucion i rëndësishëm, duhet të jemi të vëmendshëm për mënyrën se si flasim dhe shkruajmë për të!


Çdo shtet në botë mundohet që qytetarëve të vet t'iu ofrojë një jetë sa më të mirë. Kjo e mirë arrihet përmes mënyrave të ndryshme. Në artikullin tonë, do të informoheni se si shteti ynë Kosova u mundëson qytetarëve të vet një të ardhme me arsim e shumë gjëra të tjera

Grupi ynë sot ka mësuar më shumë rreth një institucioni shumë të rëndësishëm, si dhe rëndësisë së tij në jetën tonë. Së pari, si fëmijë dhe së dyti si qytetarë. Ky pra, është Kuvendi, që ndryshe quhet si „Shtëpia e Popullit“. Ky institucion e ushtron Pushtetin Legjislativ, sepse merret me miratimin e ligjeve. Por, ka edhe raste që projektligje të ndryshme të mos miratohen. Ligjet të cilat miratohen në Kuvend, pa dyshim që janë për të mirën e vendit. Janë deputetët ata të cilët bëjnë miratimin e këtyre ligjeve, dhe e dijme që deputetët quhen përfaqësuesit e popullit. A nuk po iu duket edhe juve, të dashur lexues se në njëfarë mënyre edhe ne jemi pjesë e vendimmarrjes?! Kur themi ne, mendojmë për qytetarët të cilët janë mbi moshën 18 vjeçare dhe që kanë marrë dhe marrin pjesë në procesin zgjedhor. Dikush nga lexuesit mund të thotë se pse është e rëndësishme të mësojmë ne për punën që e bën Kuvendi dhe vendimet të cilat merren aty, kur e dijme që ne jemi vetëm fëmijë të moshës 11 apo 12 vjeçare. Ne, më shumë kujdes dhe përkushtim iu tregojmë se po të mos ishte ky institucion, ne nuk do të dinim si të shkruanim, por edhe ju të dashur lexues nuk do të kishit mundësi t'iu lexoni dhe t'iu kuptoni të gjitha këto që ne kemi shkruajtur. Si mund të ndodhë kjo, mund t'ia përshpëris dikush vetes? Kjo mundësohet fal ligjeve të cilat i miraton Kuvendi. Ky ligj njihet si Ligji për

Arsim, dhe çdo qytetar i Kosovës është i obliguar ta zbatoj atë. Në këtë mënyrë vërehet edhe ndikimi dhe prania e Kuvendit në jetën tonë. Ligje si ky, që ndikojnë në jetën tonë ka edhe shumë të tjerë, mirëpo ne ndihemi të obliguar t'iu tregojmë pak edhe për funksionet që Kuvendi ka. Shpresojmë që deri këtu e keni kuptuar punën dhe rëndësinë e ligjeve. Kuvendi ka detyra të shumta, por si tri funksione kryesore të tij ka: përfaqësimin e popullit, miratimin (mos miratimin) e ligjeve, si dhe mbikëqyrjen e Qeverisë. Populli përfaqësohet nga 120 deputetë dhe të gjithë punojnë për të mirën e çdo qytetari, duke miratuar ligje. Në mënyrë që të gjitha ligjet të zbatohen, ashtu siç e kërkon Kuvendi, punon Qeveria. Për këtë, Kuvendi e mbikëqyr punën e saj. Sipas nesh, Kuvendi për shtetin është sikurse që është oksigjeni për ne, njerëzit.



Gazetarët e së ardhmes



IMPRESUM



Ky publikim është produkt i punës së pjesëmarrësve të projektit „Demos-ti“ i cili realizohet nga



REPUBLIKA E KOSOVËS / KUVENDI
REPUBLIKA KOSOVA / SKUPŠTINA
REPUBLIC OF KOSOVO / ASSEMBLY

i implementuar nga



Projekti është mundësuar dhe përkrahur nga



ERSTE Stiftung

Redaktohet nga
Kuvendi i Kosovës

Qëllimi i publikimit
Edukimi qytetar nëpërmes metodave edukative joformale

shtypur nga
TOKA

Na kontaktoni për të marrë pjesë: Pjesëmarrësit:
Tel: +381 38 704 560 SHFMU „Akrashticë“
E-mail: info@demos-ti.org Klasa: VI-1
Website: www.demos-ti.org Vendi: Akrashticë, Vushtrri